



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:038583

Datë: 12.02.2020

Numri i dokumentit: 00827357

P. nr. 998/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.D dhe N.K, për shkak të veprës penale, Dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezimimi i sigurisë në vendin e punës, nga neni 367 par.5 lidhur me par.3 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 411/2017, e datës 28.04.2017, sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 23.01.2020, në prezencë të palëve mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 10.02.2020, përpiloi këtë :

AKT GJYKIM

I akuzuari R.D, nga babai F., i lindur më .. ,në fsh.....,K e Kamenicës,me vendbanim në Gjilan, në rr. “...” ,drejtor në agjensionin turistik “M...”në Gjilan, i martuar,i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 26.12.2016, rreth orës 13:20 min., në Gjilan, në rr. e“Kamenicës”, përballë ”D..M..”, brenda rrethojave të kontrollimit teknik “I...”,i akuzuari si person i autorizuar për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës nuk i ka instaluar pajisjet mbrojtëse , në atë mënyrë,deri sa i dëmtuari A.V ishte në punë dhe në momentin kur ka dashur me e mbyll derën e garazhës,së bashku me dy punëtorë të tjerë,R.Xh dhe A.K ,dera e garazhës ka qenë shumë e madhe dhe e rëndë dhe për një moment dera ka dal nga valëzat rrëshqitëse – llagerat dhe ka rënë mbi trupin e të dëmtuarit A.V, i cili bie në tokë pa ndjenja dhe fillimisht dërgohet në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan–Emergjencë, e më pas, pasi që të dëmtuarit i keqësohet gjendja, dërgohet për operim në QKUK,në Prishtinë,reparti i ortopedisë, me qka i akuzuari nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë ka rrezikuar jetën e njerzve ,në këtë rast të dëmtuarit A.V,i cili pëson lëndime të rënda trupore, me thyrje e shumfishtë e filxhanit nga ana e majtë dhe kockës

publike, ndërsa lëndime të lehta trupore pëson edhe i dëmtuari tjetër R.Xh, i cili kërkon ndimë mjeksore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan –Emergjencë.

- me çka, në bashkëveprim ka kryer veprën penale, **Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pasijëve mbrojtëse dhe rrëzikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par.5 lidhur me par.3 të KPPRK-ës,**

Në bazë të nenit 76 par.1.7 të KPRK-së, e dënon me

ME DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin R.D, në shumë prej **600 (gjashtëqind) €** të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, dënimi i përmendur do t'i shndërrohet në dënim burgu, duke llogaritur për çdo 20 € një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **20 (njëzet) €** e gjithë këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit A.Vdhe R.Xh, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Veçohet procedura penale ndaj të akuzuarit **N.K** për shkak se i nejtë është jashtë Kosovës dhe për të nejtin do të leshohet Letër-rreshtim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr. 411/2017, e datës 28.04.2017 kundër të akuzuarve R.D dhe N.K , për shkak të veprës penale, asgjësimi,dëmtimi ose heqja e pasijëve mbrojtëse dhe rrëzikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par.5 lidhur me par. të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjyqtarja, më datën 20.05.2019, ka marrë aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit, të cilit ia ka shqiptuar një dënim me gjobë, në shumën prej 600 € në bazë të nenit 76 **par.1.7 të KPRK-së, i cili parasheh se, citoj: nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim.**

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, për shkak të vendmit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që Gjykkata e Apelitaktgjykimin e apeluar ta ndryshojë dhe ndaj të akuzuarit të shqiptojë dënim efektiv me burg, ndërsa, brenda afatit ligjor, përgjigje në ankesën e prokurorit ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, av. Burim Islami, me propozim që që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykta e Apelit ka konstatuar se dënimi i shqiptuar me gjobë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se arsyet për dënimin shqiptuar janë të paqarta. Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka vërejtur se zëvendësimi i dënimit me burg në rast të mospagesës nga ana e të akuzuarit, do të llogaritet për çdo 15 € një ditë burgu, gjë që është gabim teknik, e jo llogaritje e saktë, andaj, në

aktgjykimin e tanishëm, gjykata e ka bërë përmirësimin e këtij gabimi, duke e llogaritur për çdo 20 €një ditë burgu.

Sa i përket arsyeve për zbutjen e dënimit sipas nenit 76 par. 1.7 , gjykata si rrethana lehtësuese ka marrë pranimin vullnetar të fajsisë nga ana etë akuzuarit, pendimi i tij, fakti se ai për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sjelljet e tij pas kryerjes së kësaj vepre penale, është njeri familjar që mban familjen me pagën që e fiton me punë në subjektin afarist “M...”, pronar i së cilës është i akuzuari tjetër, N.K, duke konsideruar si rrethana të mjaftueshme për zbutjen e dënimit, rrethana këto që tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e këtij dënimi.

Meqenëse i akuzuari R.D përsëri e pranoi fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i cili pranim është bërë pa presion, me vullnet të lirë, i njoftuar nga gjykata lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë, nuk pati nevojë të shtjellohen prova të tjera.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 998/19, më datë 10.02.2020**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljeta Shabani, d.v.**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj Gjykate.